

VEPRIMTARIA POLITIKE E AQIF PASHË BIÇAKUT NË KONGRESIN KOMBËTAR TË LUSHNJËS

FLORENCA STAFA, ZHULJETA KADILLI

Departamenti i Historisë dhe Gjeografisë, Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti
“A.Xhuvani”, Elbasan

Email: florencastafa@yahoo.com

AKTET VI, 3: 190 - 193, 2013

PËRMBLEDHJE

Ky artikull synon të vlerësojë kontributin politik të Aqif Pashes gjatë zhvillimit të Kongresit të Lushnjës. Në këtë kongres Kombëtar duhej të mundësohej krijimi i një qeverie kombëtare, që të harmonizonte të gjitha përpjekjet për të evituar kërcënimin real nga fituesit e luftës. Programi i shpallur në Kongres u pasua nga një lëvizje që u shtri shpejt në të gjithë vendin. Edhe politika e jashtme mori një dimension të ri pozitiv për qeverinë e Tiranës. Aqif Pasha duke qenë në krye të punimeve i dha tonin patriotik e kombëtar frymës së Kongresit. Për të realizuar këtë punim jemi mbështetur në një literature të pasur historike si dhe në burimë arkivore. Jemi përpjekur që interpretimit t'i japim një dimension të ri për këtë figurë. Kongresi i Lushnjës finalizoi shkëputjen e Shqipërisë nga të huajt dhe i tregoi botës dhe vehtes se, këta njerëz dinin të bënin politikë, e të vetqeveriseshin me elementët e shtetit të tyre. Asnjëherë në historinë e kombit shqiptar, theksonte Aqif Pasha, populli shqiptar nuk ka qenë më i bashkuar se kurrë me një dëshirë të patundur që të ketë qeverinë e tij.

Fjalë kyçe, Aqf Pasha, patriot, program, qeveri e Tiranës, vetqeverisje

Përmbledhje

Programi i shpallur në Kongresin e Lushnjës u pasua nga një lëvizje që u shtri shpejt në të gjithë vendin. Edhe marrëdhëniet e jashtme morën një drejtim pozitiv për Qeverinë e Tiranës.

Rëndësi të veçantë pati gjithashtu deklarata e kryetarit të Këshillit të Lartë Aqif Pashë Elbasanit dhënë shtypit shqiptar mbi gjendjen e brendshme e të jashtme të Shqipërisë pas Kongresit të Lushnjës.

“Asnjëherë në historinë e kombit shqiptar, theksonte ai, populli nuk ka qenë i bashkuar si është sot me një dëshirë të patundur që të ketë qeverinë e vet për vendin e vet, sipas formulës Shqipëria për shqiptarët.

Hyrje

Më 21 janar 1920, ditën e caktuar për çeljen e kongresit, nuk kishin mbërritur ende shumica e delegatëve, për shkak të vonësës së shpërndarjes

së “letërthirrjeve”, siç thuhej në vetë procesvebalin e mbledhjes. U vendos për çeljen simbolike të Kongresit, si dhe shtyrjen e punimeve të tij për javën e ardhëshme. Megjithatë, 21 janari i orës 10 të mëngjesit u konsiderua nga të gjithë delegatët si “çelja (seanca) e parë e mbledhjes kombëtare “ dhe hyri si e tillë në historinë e këtij kongresi. Më 28 Janar, pas disa ditë pushimi, Kongresi i filloi sërish punimet, ku ishin mbledhur të gjithë delegatët. Ditën e hapjes së kongresit qyteti i Lushnjës ishte zbukuruar nga të gjitha anët me flamuj kombëtarë. Porta e ndërtesës, ku do të mbahej kongresi, ishte zbukuruar me dafina dhe mbi të ishin ngritur tre flamurë. Në sallën ku u mbledhën delegatët, ishin vendosur portretet e Skëndërbeut dhe Ismail Qemalit dhe mbishkrime si “Rroftë Shqipëria” e të tjera. Në Kongresin historik Kombëtar të Lushnjës, Qarku i Elbasanit u përfaqësua nga: Aqif Pashë Elbasani (Peqin), Filip Papajani, Sali Çeka (Gramsh, Sulovë, Dumre),

Adem Gjinishi (Peqin), Qazim Dyrmishi, Shaban Bloshmi, Asllan Shahini.

Mbledhja e Kongresit

Aqif Pashë Elbasani u përfaqësua në kongres si delegat i Peqinit pasi ky njeri kishte konflikte të shpeshta me elementë konservatorë, e sidomos armiqësitë e vjetra me Shefqet Vërlacin, si dhe me kryetarin e bashkisë së asaj kohe Kasem Sejdinin. Ky i fundit, për shkak të konfliktit që kishte me vetë Aqifin kur kishte ardhur në Elbasan qarkorja e komisionit përgatitor të Kongresit të Lushnjes, kishte vendosur në mbledhjen e këshillit të bashkisë së Elbasanit për të mos marrë pjesë. Kjo edhe për një arsye tjetër, pasi kështu Elbasani dilte hapur kundër Qeverisë së Durrësit. Në këtë mënyrë nisi lëvizja e nacionalistëve vendas, të cilët bënë të pamundurën për të bindur kryetarin e bashkisë që edhe Elbasani të përfaqësohej në kongres, duke e mbajtur të fshehtë kandidaturën e Aqif Elbasanit si delegat i Peqinit. Nga qarku i Elbasanit, shkoi në Lushnje edhe një forcë e armatosur për mbrojtjen e delegatëve të Kongresit dhe garantimin e zhvillimit normal të punimeve të tij.

Kongresi zgjodhi kryesinë për drejtimin e punimeve me kryetar Aqif pashë Elbasanin dhe me nënkryetar Sotir Pecin. Pra, Aqif Pashë Elbasani ishte kryetar i kongresit dhe kryetar i Këshillit të Lartë të dalë nga ky Kongres. Zgjedhja e Aqif Pashë Elbasanit si kryetar i kongresit u bë me propozimin e Ikonom Dhimës, i cili nxirrte në pah konsideratat e thella për Aqif Pashën.

Duke qenë edhe në cilësinë e Kryetarit të Këshillit të Lartë, të organit i cili përfaqësonte sovranitetin shtetëror, ai caktonte kryeministrin dhe kryente duke u konsultuar me anëtarët e tjerë të këtij Këshilli, funksionet e kryetarit të shtetit. Seancën e parë Kongresi i Lushnjes ia kushtoi veprimtarisë dhe punës së madhe të atdhetarit Abdyl Ypi dhe me këtë rast, kryetari i mbledhjes, Aqif Pashë Elbasani, i dërgoi një letër ngushëllimi familjes së tij, në të cilën vinte në dukje se "Abdyl Ypi nuk mori parasysh asnjë rrezik të jetës së tij për shpëtimin e Atdheut dhe për mbledhjen kombëtare të Lushnjes, prandaj u ba theror, dëshmor i Shqypnisë". Me vendim të kongresit , më 12 shkurt 1920, kryeqyteti i Shqipërisë u shpall

Tirana, një qytet i vogël me një popullsi prej 12 mijë banorësh.

Hyrja e Qeverisë në kryeqytetin e ri, Tiranë, midis tyre dhe Aqif Pashë Elbasani.

Kongresi i Lushnjes që drejtonte Aqif Pashë Elbasani mori disa masa në planin e jashtëm e të brendshëm:

Në planin e jashtëm, masat e marra kishin të bënin me kundërshtimin e synimeve imperialiste, siç qenë ato për copëtimin e plotë të Shqipërisë, për zvogëlimin e mëtejshëm të saj, apo për vënien e shtetit shqiptar në varësi të huaj. Për të mbrojtur të drejtat e Shqipërisë në Konferencën e Paqes në Paris, kongresi zgjodhi një delegacion të posaçëm prej tre vetash ku bënin pjesë:

1. Mehmet Konica
2. Luigj Bumçi
3. Mihal Turtulli

Në hapat e ndërmarrë nga Kongresi në fushën diplomatike pasqyrohet fryma e vendosmërisë së patundur për mbrojtjen e pavarësisë dhe të tërësisë tokësore të shtetit shqiptar. Kjo ishte edhe vija që i përcaktonte Kongresi i Lushnjes delegacionit të zgjedhur prej tij për në Konferencën e Paqes.

Në planin e brendshëm, në Kongres u diskutua për shumë çështje, e një ndër to që shqetësonte Aqif Pashën ishte dhe situata në Konferencën e Paqes së Versajës. Në Kongres u vendos të shkarkohej delegacioni shqiptar që zgjodhi qeveria e Durrësit e, si rrjedhojë, edhe për rrëzimin e delegacionit që përfaqësonte Shqipërinë në emër të kësaj qeverie, duke ia lënë vendin zgjedhjes së një delegacioni të ri.

Midis çështjeve juridike kushtetuese të sanksionuara në statut rëndësi të veçantë mori ajo e formës së qeverisjes, ose e *formës së shtetit*. Zgjidhja që i dha ai çështjes së formës së qeverisjes përmbahej në nenin përkatës, që fliste për Këshillin e Lartë si ushtrues i detyrimeve të "Fronit të Naltë Mbretëror". Në këtë rast sanksionohet në mënyrë pak të tërthortë, ruajtja e monarkisë, si formë e përkohshme e qeverisjes për shtetin shqiptar. Pati debate të shumta. Një pjesë e delegatëve ishin shprehur për rikthimin e Princ Vidit, ide e mbështetur kjo dhe nga vetë Aqif Pasha, kurse një pjesë tjetër ishin për Republikë.

Ndoshta Aqif Pashë Elbasani shikonte tek rikthimi i Vidit konsolidimin e strukturave shtetërore të vendit, si dhe oksidentalizimin e shtetit të ri shqiptar, pasi regjimi i Vidit ishte një regjim perëndimor, e vendit i duhej një orientim i tillë (shënimi im). Ky mendim i Aqif Pashës e ka një shpjegim pasi Vidi nuk kishte abdikuar asnjëherë nga fronti, ai thjesht ishte larguar, duke e lënë vendin në fakt me një formë regjimi Monarkike. Pati në të vërtetë debate të shumta, të cilat si bosht të kundërshtimit të tyre të kësaj forme regjimi, përdorën arsyetimin që Shqipëria nuk ka mundësi ekonomike për të mbuluar shpenzimet e oborrit.

Sigurisht, në kohën kur Kongresi i Lushnjes vendoste të ruante si formë qeverisjeje monarkinë, kjo e fundit ishte vjetëruar kudo në botë. Statuti e shpallte Shqipërinë Principatë dhe krijoi një Këshill të Lartë Regjence të përbërë nga një përfaqësues prej së cilës nga katër komunitetet fetare shqiptare, një katolik, një ortodoks, një musliman-sunit, dhe një bektashian.¹ Për më tepër, me vetë ngjarjet e Shqipërisë, monarkia dhe Vidi i imponuar nga jashtë si monark, jepnin vetëm kujtimin e hidhur të minimin të pavarësisë shqiptare të shpallur më 28 nëntor 1912. Megjithatë, Kongresi i Lushnjes vendosi të mos i priste lidhjet e shtetit shqiptar me këtë formë qeverisjeje. Kjo kishte arsytet e veta në rrethanat e brendëshme dhe të jashtme të asaj kohe.

Në planin e brendshëm ruajtja e monarkisë kishte lidhje në kompromisin e asaj kohe midis feudalëve dhe borgjezisë. Ajo ishte lëshim që i bëhej shoqërisë së vjetër.

Në planin e jashtëm, ruajtja e monarkisë kishte lidhje me gjendjen kritike të Shqipërisë në atë kohë, kur, siç deklarohet në Kongres, bëheshin krasitje në trupin shqiptar brenda kufijve të caktuar më 1913 nga "gërshana e pamëshirshme e diplomacisë". Në këto kushte Kongresi u përpoq të mos binte ndesh me vendimet ndërkombëtare për shtetin shqiptar, siç qe vendimi i Konferencës së Ambasadorëve (29 korrik 1913) dhe më vonë Statuti Organik i Shqipërisë i hartuar nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit (10 prill

1914). Me këtë Kongresi i Lushnjes theksonte ekzistencën e shtetit shqiptar si dhe njohjen ndërkombëtare që kishte marrë ai në këto vendime.

Nga Kongresi i Lushnjes dolën këto Organe:

Këshilli i Lartë- me të drejtën e Sovranit.

Këshilli i Lartë përbëhej nga katër veta me detyrën e një Regjence. Këta ishin siç e kam theksuar më lart përfaqësues të katër komuniteteve fetare shqiptare; katolik, ortodoks, musliman-sunit dhe bektashian. Katër anëtarët e tij ishin:

1. Aqif Elbasani (komuniteti bektashi)
2. Abdi Toptani (komuniteti mysliman)
3. Luigj Bumçi (komuniteti katolik)
4. Mihal Turtulli (komuniteti ortodoks)

Këshilli i Lartë kishte të drejtën vetëm të caktimit të Kryeministrit. Nuk kishte asnjë të drejtë në fushën legislative. Pozita juridike e Këshillit të Lartë nuk barazohej me atë të monarkut, megjithëse kishte pozitën e regjencës me kompetenca të kryetarit të shtetit në formën monarkiste të qeverisjes. Mbi këtë bazë ishte vendosur që të mos përdorej për anëtarët e Këshillit të Lartë titulli "madhëri" ose "lartësi", sikurse kishte ndodhur menjëherë pas Kongresit të Lushnjes.

Qeveria ose Kabineti - me të drejta ekzekutive.

Pozita juridike e kësaj qeverie qe realizimi i pushtetit ekzekutiv, sipas Statutit të Lushnjes dhe varësia e plotë nga Senati. Për ndryshimin e qeverisë dhe formimin e saj kërkohej vendimi i senatit.

Qeveria e re kryesohej nga Sulejman Delvina dhe kishte në përbërjen e saj pesë anëtarë, si titullarë të dikastereve përkatëse

Këshilli Kombëtar (Senati) - me të drejta legislative.

Senati kishte 37 anëtarë, të zgjedhur nga Kongresi sipas propozimit të delegatëve të prefekturave në bazë të numrit të popullsisë. (1 përfaqësues për 20 mijë banorë). Kishte të drejtën e emërimit dhe të shkarkimit të qeverisë dhe ushtrimin e kontrollit mbi të. Senati ishte i pavarur nga Këshilli i Naltë dhe zinte vendin e parë në organet më të

larta shtetërore. Ishte një parlament me kompetenca të gjëra. Mbledhja e parë e këtij organi shtetëror të rëndësishëm, që kishte në duart e tij pushtetin legjislativ u bë më 27 mars 1920, datë e cila shënon edhe fillimin e punës së Senatit. Që në mbledhjen e tij të parë, Këshilli i Lartë demostroi një frymë tolerance, bashkëpunimi dhe mirëkuptimi midis anëtarëve për probleme të ndryshme dhe për të manovruar në momentet më të rrezikshme. Kështu në një letër që Mihal Turtulli i dërgon kryetarit të Këshillit të Lartë Aqif Pashës, i cili për shkak të gjendjes jo të mirë shëndetësore ishte i detyruar të shkonte në Elbasan, ndër të tjera theksonte: *“punërat po bëhen shumë kritike. E ardhura e shkëlqesës sate këtu është shumë e nevojshme për të kuptuar gjithë së bashku, e për të marrë masat që lipsen...”*. Po kështu, kjo frymë mirëkuptimi duket edhe në një telegram që qeveria i drejton Aqif Pashës, ku, ndër të tjera, theksonte se: *“Konflikti me shtetin Jugosllav do të mbyllet me marrëveshje diplomatike, t’urdhnoni këtu juve se kështu e lyp nevoja”*.

Shtypi i kohës, si brenda e jashtë vendit, u bëri jehonë të madhe punimeve të Kongresit dhe vendimeve të tij. Materialet e shumta që botoheshin në shtyp, si artikujt, letrat, telegramet, informacionet jepnin të dhëna të plota mbi zhvillimin e punimeve dhe për vendosmërinë e popullit shqiptar. Në mbrojtje të interesave të kombit u dalluan veçanërisht gazetatat “Populli”, “Drita”, “Shqypnia e Re”, “Koha”, “Albania” etj. Gazeta “Populli” në Shkodër shkruante: *“Ra kabineti i Turhan Pashës. Kabineti i ri është nën kryesinë e Aqif Pashë Elbasanit. Dy thirrje patriotike. Kush po don me copëtue Shqipninë: Italia apo Jugosllavia...”* Në fakt, manifestimi i fuqishëm që gjeti patriotizmi shqiptar në vendimet e Kongresit të Lushnjës nuk ka mbetur pa ndikim në përçapjen e vetë Presidentit Wilson ndaj Akordit të 14 Janarit. Në përgjigjen e tij të 10

shkurtit 1920, ai e hidhte poshtë atë si *“ një marrëveshje të përgatitur pa dijeninë dhe pa miratimin e Qeverisë amerikane”* (i referohej Akordit të 14 Janarit). Amerika nuk do të pranonte një rregullim të tillë të *“çështjes së Adriatikut”*, në asnjë rrethanë, madje edhe sikur *“formula e propozuar të gjente miratimin e Jufosllavisë”*. Ndërrthuret dhe reagimet e Presidentit Wilson, nga një memorandum në tjetrin, krijuan një raport të ri forcash në nivelin e Fuqive të Mëdha dhe u godit diplomacia e fshehtë.

Bibliografia

1. Akademia e Shkencave, Insituti i Historisë, Drejtoria e përgjithshme e arkivave të shtetit, *Lufta e popullit shqiptar për çlirimin kombëtar 1918-1920*, “Përmbledhje dokumentash”.
2. Arkivi Qëndror Shtetëror, Tiranë
3. Fischer Jurgen, Bernard, *“Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri”*, Tiranë, Çabej, 1996
4. Hysi Gramoz, *“ Lufta politike gjatë fushatës së zgjedhjeve të Këshillit Kombëtar në fillim të vitit 1921”*, Tiranë, 1981
5. Puto Arben, *“ Historia diplomatike e çështjes shqiptare”*, Tiranë, Albin, 2003
6. Naska Kaliopi, *“Këshilli Kombëtar 1920”*, Tiranë, 2000
7. Smirnova Nina, *“Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX”*, Tiranë, Ideart, 2004
8. Veizi Fane, *“Qeveria e Kongresit të Lushnjës dhe veprimtaria e saj, 1918-1920”*, Tiranë, 8 Nëntori, 1987
9. Elbasani në Luftën për Çlirim, *“Lufta Nacional-Çlirimtare në qarkun e Elbasanit”*, Tiranë, Naim Frashëri, 1971
10. S. Dedej, *Kumtesë, Elbasani, vatër kulturore, mbajtur më 22.XII.1997. depozituar pranë Muzeut Etnografik të Elbasanit.*